

LIGJ
Nr.7378, datë 8.5.1990

PËR BANKËN BUJQËSORE

Me qëllim që Banka Bujqësore të luajë rol aktiv për zhvillimin e intensifikimin e bujqësisë dhe rritjen e efektivitetit të saj, nëpërmjet kreditimit, financimit dhe forcimit të disiplinës financiare e të kontrollit me anë të lekut.

Në mbështetje të nenit 67 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS POPULLORE SOCIALISTE TË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Banka Bujqësore si institucion shtetëror i Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë, zbaton politikën ekonomike për zhvillimin dhe forcimin ekonomiko-financiar të ndërmarrjeve e institucioneve të sistemit të bujqësisë dhe të kooperativave bujqësore, si dhe ndihmon e ushtron kontroll me anë të lekut për të parandaluar çdo veprim që vjen në kundërshtim me disiplinën e planit e të financës.

Neni 2

Banka Bujqësore ka këto të drejta e detyra:

a) U jep kredi ndërmarrjeve e institucioneve të sistemit të bujqësisë dhe kooperativave bujqësore.

b) Krye financimin e investimeve.

c) Përqëndron llogaritë e pagesave e të arkëtimeve, të ndërmarrjeve e të institucioneve të sistemit të bujqësisë dhe të kooperativave bujqësore, si dhe kryen arkëtimet e pagaesat e tyre.

ç) Jep interesa për depozitat në llogaritë bankare dhe merr interesa për kreditë e dhëna.

d) Ndihmon në hartimin dhe shqyrtimin e planit ekonomiko-financiar, bën vërejtje e jep mendime për përmirësimin e treguesve të tij, ndjek plotësimin e detyrave dhe ndihmon e rekopmandon marrjen e masave për rritjen e të ardhurave e të efektivitetit të shpenzimeve. Merr pjesë në procesin e planifikimit të investimeve kur ajo është pjesëtare në investime dhe jep mendime për përfshirjen në plan, si dhe për radhën prioritare të kryerjes së tyre.

dh) Bën vetë ose në bashkëpunim me organet e tjera analiza e studime për shtimin e fondeve themelore, përmirësimin e strukturës së prodhimit e të të ardhurave dhe për përsosjen e marrëdhënieve socialiste në bujqësi.

e) Për investime që mbulohen me kredi afatgjatë, shqyrton e kontrollin studimet, projektet dhe preventivat e tyre, ndjek dhe kontrollon zbatimin e punimeve, përfundimin dhe vënien në shfrytëzim të tyre në afat, deri në kthimin e plotë të kredisë.

ë) Ushtron kontroll me atë të lekut për përdorimin e drejtë e me efektivitet të kredive e të fondit të pagave, për krijimin dhe përdorimin e fondit të investimeve, për qarkullimin e mallrave, për arkëtimet dhe pagesat.

f) Shqyrton dhe i paraqet Bankës së Shtetit Shqiptar të dhënat e nevojshme për hartimin e planit të arkës, për të ardhurat shpenzimet e ndërmarrjeve e të institucioneve të sistemit të bujqësisë dhe të kooperativave bujqësore, si dhe nevojat për burime krediti.

g) Mban përgjegjësi për përdorimin me efektivitet të kreditit dhe për forcimin e disiplinës në financimin e investimeve e në fushën e arkëtimeve e të pagesave.

Neni 3

Për investimet që financohen nga mjetet e vetë ndërmarrjeve e të kooperativave bujqësore, si dhe nga buxheti i shtetit, Banka Bujqësore kontrollon studimin, leverdisshmërinë, planifikimin dhe financimin e tyre, në bazë të dokumentacionit që depozitohet në të. Kur vëren shkelje të rregullave dhe shmangie nga qëllimi ose destinacioni i investimeve Banka pezullon financimin dhe urdhëron ndërprerjen e punimeve, duke njoftuar organet përkatëse.

Neni 4

Banka Bujqësore jep kredi afatshkurtër e afatgjatë, me kusht që të përdoret për qëllimin e caktuar, të garantohet me vlera materiale dhe të kthehet në afat.

Burimet për dhënien e kredive formohen nga mjetet e Bankës së Shtetit Shqiptar e të Bankës Bujqësore, nga tepricat e mjeteve monetare përkohësisht të lira të ndërmarrjeve e të institucioneve të bujqësisë dhe të kooperativave bujqësore, si dhe nga buxheti i shtetit.

Neni 5

Kredia afatshkurtër u jepet ndërmarrjeve e institucioneve të bujqësisë dhe kooperativave bujqësore për plotësimin e mjeteve të xhiros për zhvillimin e veprimtarisë së tyre prodhuese.

Neni 6

Kredia afatgjatë u jepet ndërmarrjeve e institucioneve të bujqësisë dhe kooperativave bujqësore për investimet me karakter prodhues e për rikonstruksionet teknike e teknologjike të objekteve prodhuese dhe kulturave drufrutore.

Banka u jep kredi afatgjatë punonjësve të fshatit dhe të qendrave të tjera të banuara të ndërmarrjeve bujqësore për përmirësimin e kushteve të banimit, si dhe kredi të pjesshme për ndërtimin e banesave të reja vetjake.

Neni 7

Banka Bujqësore, kur vëren që kredia nuk është përdorir për qëllimin e dhënë, ndërpret kreditimin dhe kërkon kthimin para afatit të kredisë.

Kur kredia nuk kthehet në afat, ose nuk grantohet me vlera materiale, Banka Bujqësore ka të drejtë të kufizojë dhënien e mëtejshme të kredisë, të ndërpresë, ose të kërkojë kthimin e menjëhershëm të saj.

Për kreditë e pakthyera në afat zbatohet interes më të lartë se për kreditë e rregullta.

Neni 8

Kriteret për përdorimin e kreditit, të fondit të pagave, për financimin e investimeve, si dhe për interesin bankar, caktohen me dispozita të veçanta të Këshillit të Ministrave.

Neni 9

Banka Bujqësore ka fondin e themelimit prej 250 milionë lekësh.

Neni 10

Banka Bujqësore organizohet sipas parimit me llogari më vete. Nëntëdhjetë për qind e së ardhurës neto të planifikuar dhe shtatëdhjetë për qind e asaj mbi plan derdhet në buxhetin e shtetit, kurse pjesa tjetër përdoret për fuqizimin e fondeve të bankës, për investime etj., sipas krieteve të miratuara me dispozita të veçanta.

Bilanci vjetor i Bankës Bujqësore mirtohet nga Këshilli i Ministrave.

Neni 11

Shteti garanton të gjitha detyrimet e Bankës Bujqësore, që rrjedhin nga veprimet e kryera në bazë të këtij ligji.

Neni 12

Banka Bujqësore është person juridik, me qendër ë Tiranë, ka rrjetin e saj në rrethe, varet nga Drejtori i Përgjithshëm i Bankës së Shtetit dhe përgjigjet e jep llogari para tij. Drejtoria e Bankës Bujqësore, për kryerjen e detyrave, ka aparatën e saj.

Drejtori i Bankës Bujqësore përgjigjet për gjithë veprimtarinë e saj, e përfaqëson atë ose autorizon të tjerë që ta përfaqësojë.

Neni 13

Në Drejtorinë e Bankës Bujqësore krijohet Këshilli i Bankës, si organ këshillimor, që kryesohet nga drejtori i saj. Përbërja e Këshillit të Bankës të Bankës Bujqësore miratohet nga Drejtori i Përgjithshëm i Bankës së Shtetit Shqiptar.

Neni 14

Degët e Bankës Bujqësore në rrethe varen nga Drejtoria e Bankës Bujqësore. Për kryerjen e funksioneve e të detyrave ato kontrollohen e japin llogari para saj, si dhe para komitetit ekzekutiv të këshillit popullor të rrethit.

Neni 15

Ndërmarrjet e institucionet e sistemit të bujqësisë dhe kooperativat bujqësore, sipas kërkesës së Bankës Bujqësore, i paraqesin asaj planet financiare, bilancet dhe të dhëna të tjera, për të bërë studime, analiza e kontrole me karakter ekonomiko-financiar.

Neni 16

Banka Bujqësore, për shkelje të dispozitave të këtij ligji, ka të drejtë të ngarkohë me përgjegjësi administrative e materiale shkaktarët, sipas rregullave të përcaktuara me dispozita të veçanta.

Neni 17

Banka Bujqësore ka vulën e saj me shenjat e stemës së Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë.

Neni 18

Dekreti nr.5530, datë 25.2.1977 “Për Bankën Bujqësore”, shfuqizohet.

Neni 19

Ky ligj hyn në fuqi më 1 janar 1991.

SEKRETARI I PRESIDIUMIT TË KUVENDIT
POPULLOR TË REPUBLIKËS POPULLORE
SOCIALISTE TË SHQIPËRISË
SIHAT TOZAJ

KRYETARI I PRESIDIUMIT TË KUVENDIT
POPULLOR TË REPUBLIKËS POPULLORE
SOCIALISTE TË SHQIPËRISË
RAMIZ ALIA